



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

U R D H Ë R

Nr.12, date 04.11.2010

Për

“Lidhjen e Marrëveshjes për Akses dhe Interkoneksion midis Albanian Mobile Communications sh.a dhe Mobitel WLC sh.a”

Në mbështetje të nenit 60 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të AKEP nr. 1296, date 11.06.2010, Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar, VKD nr.1441, date 04.11.2010 “Për mbylljen e procedimit të filluar me VKD nr. 1352, datë 06.08.2010 “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për moslidhje marrëveshje interkoneksioni midis Mobitel WLC sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a”,

U R D H Ë R O J:

1. Albanian Mobile Communications sh.a dhe Mobitel WLC sh.a të lidhin marrëveshje interkoneksioni brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij Urdhëri;
2. Marrëveshja e Interkoneksionit të lidhet:
 - a. Sipas përcaktimeve të ofertës reference të interkoneksionit në fuqi të Albanian Mobile Communications, dhe marrëveshjeve të lidhura me palët e tjera;
 - b. Me kapacitet sipas parashikimeve të Aneksit V të Marrëveshjeve të Intekoneksionit të lidhura me palët e tjera;
3. Palët të depozitojnë në AKEP një kopje të Marrëveshjes së Interkoneksionit të nënshkruar nga palët brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit;
4. Moszbatimi i këtij Urdhëri përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas parashikimeve të nenit 137 të ligjit nr. 9918 date 19.05.2008;

Ky Urdhër hyn në fuqi në datën e publikimit të tij në faqen e Internetit të AKEP.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N Ë T A R Ë:

- 1. Alketa MUKAVELATI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Ibsen ELEZI**
- 4. Zamira NURÇE**